



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Republika e Kosovës / Republika Kosovo	
ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS	
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA	
VENDIMI I KËTË LLOJËS SE PRERË	
QËLËJA ËSHTË PRAVSHMËSHËNE	
Data Lokali	16.08.2023 vit. god.
Punonjësi i autorizuar Qeveritar radnik	

KA.nr.1075-8/2022

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë prej Daut Rudi- Kryetar, Edona Sina dhe Agim Shala - anëtar, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses-Valbona Hoxha praktikante në OAK-ë, duke vendosur sipas ankesës nr. Nr.1075-1/22 të datës 29/08/2023 e ushtruar nga
kundër vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinore të OAK-së, nr.1075-5/22 datës 16.08.2023, në seancën jo publike të mbajtur me datë 06.10.2023, njëzëri mori këtë:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa nr.75-1/2022 të datës 29/08/2023 e ushtruar nga fletparaqitësi
- II. **VERTETOHET** si i bazuar dhe i ligjshëm Vendimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor i OAK-së, nr.1075-5/2022 datës 16.08.2023

Arsyetim

Zyra e Prokurorit Disiplinor i Odes së Avokateve të Kosovës (më tutje: ZPD) me Vendimin nr.1075-5/2022 datës 16.08.2023 ka Hudhe poshtë fletëparaqitjen disiplinore nr.1075-1/22 e datës 29.08.2023 të ushtruar nga _____ në emër të _____, kundër av. _____ me nr.licence _____ dhe avokat _____ me nr.licence _____, me arsyetim se nuk është vërtetuar se të paraqiturit kanë kryer shkelje disiplinore të normuara me normativat e OAK-së.

Kundër këtij vendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë parashtruesi i fletparaqitjes me pretendim se vendimi i goditur i ZPD-së është marrë me shkelje të dispozitave të Rregullores për Procedurën Disiplinore dhe të Ligjit të Avokatisë dhe zbatim të gabuar

të së drejtës materiale, me propozim që Komisioni i ankesave vendimin e goditur të ZPD-së ta anuloj dhe çështjen të kthej në shkallë të parë për rishqyrtim. Poashtu avokatët e paraqitur brenda afatit ligjor kanë parashtruar përgjigje në ankesën e fletëparaqitësit, me propozim që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e fletëparaqitësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i ZPD-së.

Komisioni i Ankesave sipas detyrës zyrtare fillimisht është kujdesur lidhur me afatin e parashkrimit, dhe konstatoj se nuk është arritur parashkrimi në këtë çështje disiplinore.

Fletëparaqitësi, në ankesën e parashtruar pretendon se ZPD-ja fare nuk është marrë me përmbajtjen e fletëparaqitjes *"se të paraqiturit-avokatët janë në gjini babë e bir dhe se kanë bërë ndarjen e rasteve në mënyr joetike, madje edhe pjestar të familjes, vetëm me qëllim të përfitimit në dëm të ushtruesit të fletëparaqitjes"* e poashtu duke cekur *"se avokatët e paraqitur kanë dhënë adresa të ndryshme të zyrave e që kjo nuk është relevante"* me ç'rast avokatët e paraqitur kanë bërë shkelje nga neni 106 pika 3 e Statutit të OAK-së dhe nenit 8 të KEPA-së, e që të gjitha këto ZPD-ja fare nuk i ka shqyrtuar.

Komisioni i Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve në ankesë dhe përgjigjen në ankesë, konstatoi se në rastin konkret pretendimet për shkelje disiplinore nga neni 106 pika 3 Statutit të OAK-së dhe nenit 8 të KEPA-së, janë të paqëndrueshme e që këto dispozita të cituara në ankesë edhe nuk përcaktojnë as shkeljet e pretenduara me fletëparaqitje, ashtu që Vendimi i goditur i ZPD-së është i ligjshëm.

Konkretisht nga shkresat e lëndës konstatohet se avokatët e paraqitur edhe pse janë në gjini babë dhe bir, të njejtit kanë zyra të ndara dhe se është e drejtë e secilës palë që të bënë zgjedhjen e saj për angazhim të avokatit për përfaqësim pran organeve dhe institucioneve tjera, ashtu që fakti se të njejtit janë në gjini babë dhe bir nuk përbën shkelje disiplinore edhe në rastin kur palët janë poashtu familjar, dhe se shkelje do të konsiderohej poqëse dy avokat kanë dhe punojnë në të njejtën zyre, ashtu që në rastin konkret avokatët e paraqitur punojnë në zyre të ndara, e që kjo vërtetohet nga provat në shkresat e lëndës, e të cilin fakt nuk e konteston edhe parashtruesi i fletëparaqitjes, respektivisht i ankesës.

Andaj Komisioni i Ankesave ka konstatuar se ZPD-ja me të drejte e ka hedhur poshtë fletëparaqitjen e lartpërmendur.

Komisioni për Ankesa në mbështetje të dispozitave nga nenit 45 paragraf 1 pika 1.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, vendosi njëzëri si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
KA.nr.1075-8/2022 të datës 06.10.2023

Kryetari e Kolegjit për Ankesa

Av. Daut Rudi

